



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë  
Izborni Panel za Zhale i Predstavke



ZL Anr.1082/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendlodur përkitazi me ankesën e Ali Tafarshiku nga subjekti politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër Berat Dana, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në seancën e panelit të mbajtur më datë 21.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me të cilën kërkohet që të shqiptohet dënim me gjobë ndaj Berat Dana, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal Gjakovë, nga radhët e PDK-së për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave,

## A r s y e t i m

Me datën 18.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Alternativa, dega Gjakovë, me të cilën pretendon se me datë 18.11.2017 kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë, Berat Dana, ka bërë fushatë duke shpërndarë shkrime në rrjetin e tij social-facebook, me përshkrimin “..Miq dhe dashamir ku është PDK mbështeteni edhe ju për të mirën e e këtij qyteti që asnje herë nuk ishim të lidhur me qendër... ” duke bërë shkelje të dispozitës së nenit 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, subjekti politik PDK e konsideron si të pa bazuar kërkesën e parashtruar nga subjekti politik Alternativa sepse sipas tyre thirrja e cila është bërë në facebook nga Berat Dana ka qenë e përgjithshme dhe askund nuk përmendet në mënyrë decidive ky apo ai subjekt.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

## Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit Alternativa, paraqitur kundër Berat Dana, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Paneli i vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë e refuzoj ankesën, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36.1 pika b) e LZP-së, për arsyen se Berat Dana, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal Gjakovë, nuk mund të vërtetohet se ka bërë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore pasi që nga fotografitë e shpërndara në rrjetin social facebook, nuk mund të identifikohet koha dhe data e shpërndarjes së fotografisë së të njejit.

Andaj në mungesë dëshmive të qarta dhe bindëse siç kërkohen me nenin 117 dhe nenin 118.1 të LZP-së paneli vendosi si në dispozitiv të këtijë vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

ZL.Anr.1082/2017 me datën 21.11.2017

Kryesues i Panelit

Hasan Shala

### ***Udhëzim Juridikë:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*